



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri:78

Tiranë – E martë, 10 maj 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 34/2016, datë 28.4.2016	Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)... 4445
Rezolutë e Kuvendit datë 28.4.2016	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015..... 4447
Rezolutë e Kuvendit datë 28.4.2016	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015..... 4448
Rezolutë e Kuvendit datë 28.4.2016	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për vitin 2015..... 4449
Rezolutë e Kuvendit datë 28.4.2016	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2015..... 4451
Rezolutë e Kuvendit datë 5.5.2016	Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2015..... 4453
Rezolutë e Kuvendit datë 5.5.2016	Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2015..... 4455
Dekret i Presidentit nr. 9554, datë 3.5.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 4457
Rregullore e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 1, datë 22.4.2016	Mbi funksionimin e Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik për Peshkimin dhe Akuakulturën..... 4457

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 25.4.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 610, datë 12.6.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2015-1109, datë 16.4.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	4459
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Gramos Memushaj.....	4465
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Klodian Londo.....	4465



**VENDIM**  
**Nr. 34/2016**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,  
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË  
POZICIONEVE TË PUNËS TË ENTIT  
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT  
E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË  
NDOTURA (ERRU)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU),

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**


- I. Struktura e ERRU-së është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.
- II. Organika e ERRU-së është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.
- III. Numri i punonjësve është 28.
- IV. Vendimi nr. 94, datë 30.4.2007, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU), i ndryshuar me vendimin nr. 162, datë 28.2.2008, shfuqizohet.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 28.4.2016

**STRUKTURA ORGANIZATIVE E ERRU-SË**

*Lidhja nr.1*





**ORGANIKA E DETAJUAR E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT  
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA (ERRU)**

KOMISIONI I ERRU-SË	Kategoria e pagës	Numri
<b>KRYETARI</b>		1
<b>ANËTARË KOMISIONI</b>		4
Sekretarja e Komisionit dhe Kryetarit		1
<b>DREJTORIA TEKNIKO-EKONOMIKE</b>		<b>9</b>
Drejtor drejtorie	II-b	1
<i>Sektori Teknik dhe i Licencave</i>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist i rrjeteve inxhinierike të ujësjellësve dhe ITUP-së	III-b	1
Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUN-së dhe ITUN-së	III-b	1
<i>Sektori Ekonomik dhe i Tarifave</i>		
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist i analizës ekonomiko-financiare	III-b	1
Specialist i analizës së aseteve dhe investimeve	III-b	1
<i>Sektori i Monitorimit dhe Performancës</i>		
Specialist i performancës operative dhe cilësisë së shërbimit	III-b	1
Specialist i performancës ekonomiko-financiare	III-b	1
<b>DREJTORIA JURIDIKE DHE E KONSUMATORIT</b>		<b>5</b>
Drejtor drejtorie	II-b	1
<i>Sektori Juridik</i>		
Specialist ligjor	III-b	2
<i>Sektori i Marrëdhënieve me Publikun dhe Konsumatorin</i>		
Specialist i trajtimit të ankesave	III-b	1
Specialist i marrëdhënieve me publikun	III-b	1
<b>DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>		<b>8</b>
Drejtor drejtorie	II-b	1
<i>Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Financiare</i>		
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist finance	III-b	1
<i>Sektori i Shërbimeve</i>		
Specialist IT	III-b	1
Specialist protokoll-arkiv	IV-b	1
<i>Punonjës mbështetës</i>		
Shoferë		2
Magaznier dhe sanitare		1
<b>TOTALI</b>		<b>28</b>



**REZOLUTË**  
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË  
INSTITUCIONIT  
TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN  
2015

**Kuvendi i Shqipërisë:**

- Vlerëson se Avokati i Popullit është një institucion kushtetues i rëndësishëm në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe se ky institucion ka një rol të veçantë në nxitjen e standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend;

- Duke vlerësuar rolin proaktiv të Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në veçanti, të grupeve më të dobëta në shoqëri;

- Duke vlerësuar rëndësinë e rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe ndjekjen në vazhdimësi të zbatimit të tyre nga institucionet, të cilave u janë adresuar;

- Duke vlerësuar rëndësinë që ka zbatimi i rezolutave të Kuvendit për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit;

**Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi raportin vjetor për veprimtarinë e Avokatit të Popullit gjatë periudhës 1 janar - 31 dhjetor 2015 dhe përmbushjen e detyrave të lëna në rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, të miratuar më 14 maj 2015 dhe konstaton se gjatë vitit 2015:**

- Numri i rekomandimeve drejtuar administratës publike është pothuajse i njëjtë si në vitin 2014. Avokati i Popullit ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme zbatueshmërinë e rekomandimeve që u ka adresuar institucioneve, në mënyrë të veçantë rekomandimet e pranuar nga institucionet, mënyrën sesi ato zbatohen nga institucionet përkatëse.

- Numri i ankesave të trajtuara nga të tria seksionet dhe në veçanti ankesat e trajtuara nga seksioni i administratës është rritur në raport me vitin e kaluar.

- Avokati i Popullit ka ndjekur zbatimin e rezolutave të Kuvendit për dy raportet e veçanta të shqyrtuara në Kuvend, për të cilat u ka kërkuar institucioneve shtetërore në vijimësi zbatimin e detyrave të lëna në kuadër të këtyre rezolutave.

- Avokati i Popullit ka depozituar 5 raporte të veçanta në Kuvendin e Shqipërisë për çështje që kanë nevojë për t'u adresuar më mirë prej organeve shtetërore.

- Avokati i Popullit ka kontribuar në përmirësimin e legjislacionit, duke dhënë mendime dhe sugjerime për 28 projektligje, nëpërmjet shkresave dhe pjesëmarrjes në seanca dëgjimore, si dhe duke rritur në mënyrë të ndjeshme rolin proaktiv të tij në këtë proces.

- Avokati i Popullit ka përgatitur një plan veprimi, në lidhje me mbrojtjen e interesave të shtetasve shqiptarë nga organet e qeverisjes vendore, me qëllim monitorimin e zbatimit të legjislacionit të qeverisjes vendore, për respektimin e parimit të decentralizimit, për ofrimin e shërbimeve për shtetasit në nivel vendor, kjo dhe në funksion të ndarjes së re administrative.

- Avokati i Popullit ka ndjekur respektimin e të drejtave të njeriut në një sërë fushash, duke pasur në fokus të veçantë grupet në nevojë dhe shërbimet që u ofrohen këtyre grupeve nga organet e pushtetit vendor dhe atij qendror.

- Avokati i Popullit nuk ka përfunduar procedurat paraprake për përzgjedhjen e dy komisionerëve të rinj.

- Në shkurt 2015, institucioni i Avokatit të Popullit është vlerësuar me nivelin A nga Komiteti Ndërkombëtar Koordinues i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut. Ky vlerësim, që është niveli më i lartë i akreditimit, është tregues i përputhshmërisë së institucionit të Avokatit të Popullit me Parimet e Parisit, të miratuara në Asambleja e Kombeve të Bashkuara me rezolutën 48/134 të datës 20 dhjetor 1993.

- Institucionit të Avokatit të Popullit, në 15-vjetorin e themelimit të tij, i është akorduar titulli “Nderi i kombit” nga Presidenti i Republikës, me motivacionin: “Në shenjë vlerësimi dhe mirënjohjeje për kontributin e qenësishëm 15-vjeçar, në ruajtjen dhe mbrojtjen e lirive thelbësore të njeriut”.

**Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Avokatit të Popullit për vitin 2016:**

- Hartimin e një plani tematik për monitorimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve që u ka adresuar institucioneve, në mënyrë të veçantë rekomandimet e pranuar nga institucionet, mënyrën sesi ato zbatohen nga institucionet përkatëse.



- Të informojë Kuvendin e Shqipërisë në vazhdimësi, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të tij, për ndryshimet e nevojshme legislative në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut.

- Të përfundojë procedurat paraprake të përzgjedhjes së kandidatëve për komisioner, për dy vendet vakante të krijuara, brenda qershorit të vitit 2016.

- Të thellojë angazhimin e tij publik në mbrojtje të të drejtave të shtetasve shqiptarë, në lidhje me problematikat që këta të fundit hasin në marrëdhënie me organin e prokurorisë dhe sistemin gjyqësor, duke adresuar rastet e shkeljeve ligjore, respektivisht Prokurorisë së Përgjithshme ose Këshillit të Lartë i Drejtësisë.

- Të vazhdojë angazhimin e tij publik në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë nga organet e qeverisjes vendore, duke synuar monitorimin e zbatimit të legjislacionit të qeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve për shtetasit në nivel vendor.

- Të kontribuojë në mënyrë proaktive për përmirësimin e legjislacionit vendas, në përmbushje edhe të rekomandimeve të Progresraportit të Komisionit Evropian, ku i kërkohet Avokatit të Popullit të jetë pjesë e konsultimeve të projektligjeve në komisionet parlamentare.

- Në kuadër të funksionit si mekanizëm për parandalimin e torturës, të rrisë numrin e rekomandimeve, në mënyrë të veçantë rekomandimet për titullarët e institucioneve të sistemit të paraburgimit dhe burgjeve, si dhe të jetë më proaktiv në lidhje me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në komisariatet e policisë dhe vendet e ekzekutimit të vendimeve penale.

- Të forcojë bashkëpunimin me institucionet e tjera të pavarura të specializuara në fushën e të drejtave të njeriut, dhe në veçanti me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të vlerësohet mundësia e nënshkrimit të një marrëveshje bashkëpunimi për çështje të së drejtës për informim.

- Zyrat Rajonale të Avokatit të Popullit duhet të jenë të gatshme të monitorojnë respektimin e të drejtave të njeriut të shtetasve të huaj, të cilët, si pasojë e konflikteve rajonale, mund të

zhvendosen përkohësisht në vendin tonë si emigrantë.

Miratuar në datën 28.4.2016

KRYETARI

**Ilir Meta**

**REZOLUTË**  
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË  
KOMISIONIT  
QENDROR TË ZGJEDHJEVE  
PËR VITIN 2015

**Kuvendi i Shqipërisë:**

- Vlerëson se ushtrimi i funksioneve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, demokratike, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare është me rëndësi vendimtare për garantimin e të drejtave themelore dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës.

- Duke konsideruar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi më i lartë i përhershëm shtetëror, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultatit të tyre;

- Duke mbajtur në konsideratë se veprimtaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të udhëhiqet nga parimet e integritetit, të paanësisë, të pavarësisë politike dhe institucionale, të transparencës, e të profesionalizmit;

- Duke besuar në rëndësinë e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në procesin e reformës zgjedhore dhe duke vlerësuar rolin e saj në këtë proces të pritsëm të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor;

**Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi raportin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtarinë e tij gjatë vitit 2015 dhe shqetësimet e shfaqura në zgjedhjet lokale të vitit 2015. Në referim të çështjeve të ngritura për:**

- Bashkëpunimin me organet e qeverisjes vendore, në funksion të organizimit dhe administrimit të zgjedhjeve;

- Procesin e regjistrimit të partive politike;

- Procedurat e ngritjes dhe funksionimit të KZAZ-ve;

- Problemeve që ndikuan në zgjatjen e procesit të numërimit;

**Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:**

- Gjatë vitit 2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka realizuar përgjithësisht kërkesat dhe



detyrat e lëna nga Kuvendi, me rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit, të vitit të kaluar, për fokusimin në një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me zgjedhjet vendore të vitit 2015;

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë vitit 2015, ka organizuar zgjedhjet lokale në kushtet e funksionimit të një ligji të ri për ndarjen e re territoriale dhe pas amendamenteve të bëra në Kodin Zgjedhor;

- Problematikat e referuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të shërbejnë për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe si çështje orientuese për zgjedhjet e ardhshme.

- Viti në vazhdim nuk është vit zgjedhor, ndaj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të fokusohet në drejtimit administrative, që përshtaten dhe realizohen më mirë në një vit jozgjedhor, siç është viti 2016.

#### **Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve fokusimin në:**

- Marrjen e masave, nëpërmjet mekanizmave dhe sipas procedurave buxhetore, për të përmbyllur pajisjen me infrastrukturën ndihmëse, logjistike dhe pajime për mjediset e reja të institucionit, përpara mbylljes së vitit në vazhdim.

- Vendosjen në funksionim të Qendrës së Trajnimeve Zgjedhore edhe me mbështetjen e donatorëve, partnerë të KQZ-së, të hartojë programet e trajnimit dhe të nisë ciklin e parë të trajnimeve brenda vitit 2016.

- Organizimin dhe vënien në zbatim të planit të bashkëveprimit me njësitë e qeverisjes vendore, për identifikimin, këqyrjen, vlerësimin dhe unifikimin e përmbajtjes së praktikave zyrtare dhe dokumentacionin e qendrave potenciale të votimit, në bashkëpunim dhe nën përgjegjësinë e kryetarëve të bashkive, përpara mbylljes së vitit në vazhdim.

- Bashkëveprimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile me të cilën:

- Të marrë në shqyrtim problematikën e vërejtur lidhur me listat e zgjedhësve;

- Të shqyrtojë e të monitorojë masat e marra nga administrata e gjendjes civile;

- Të përpunojë rekomandime për rregullimet dhe përditësimin e regjistrave, si dhe t'i bëjë ato publike përpara mbylljes së vitit në vazhdim.

- Përditësimin e bazës së të dhënave për personat që nuk shikojnë, si dhe të personave në

tërësi me pengesa në aftësinë për votim, duke marrë masa për sa i përket informimit, edukimit dhe përfshirjes së përfaqësuesve të tyre në këtë trajtim të teknikës zgjedhore, përgjatë vitit në vazhdim deri në zgjedhjet e radhës.

- Vazhdimin e hartimit dhe zbatimit të programeve dhe projekteve të posaçme për pakicat kombëtare me programe informimi, edukimi dhe përfshirjen e përfaqësuesve të pakicave në trajtimin e çështjeve zgjedhore, përgjatë vitit në vazhdim deri në zgjedhjet e radhës.

- Kuvendi i Shqipërisë nxit Komisionin Qendror i Zgjedhjeve të hartojë dhe të zbatojë programe dhe projekteve njohëse për përdorimin e teknologjive të votimit apo numërimit në votim, të identifikojë teknologji premtuese dhe të adaptueshme në realitetin shqiptar të zgjedhjeve, duke i bërë të njohura për faktorin politik dhe publikun, përgjatë gjithë vitit në vazhdim dhe në vijimësi.

- Kuvendi i Shqipërisë vlerëson të dobishme fillimin e një vlerësimi të plotë nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për votimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në emigracion, me synim lehtësimin dhe garantimin e së drejtës kushtetuese të tyre për të votuar.

- Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të vendosë në dispozicion të Komisionit të Reformës Zgjedhore informacionin, dijet dhe eksperiencën teknike të përfutur si eksperiencë nga zgjedhjet e mëparshme.

Miratuar në datën 28.4.2016

KRYETARI  
Ilir Meta

#### **REZOLUTË**

#### **PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI (KMD) PËR VITIN 2015**

#### **Kuvendi i Shqipërisë:**

- Duke konsideruar mbrojtjen e së drejtës së çdo personi për barazi para ligjit, parimin e barazisë dhe trajtimin për shanse dhe mundësi të barabarta, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminim, si përparësi kyçe drejt proceseve integruese të shtetit shqiptar;



- Duke inkurajuar dhe mbështetur veprimtarinë e KMD-së, si një institucion i pavarur, i cili ka për mision garantimin për mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore;

- Duke shprehur bindjen e tij se progresi i veprimtarisë së KMD-së në drejtim të luftës kundër diskriminimit është i mundur vetëm në sajë të një sistemi të harmonizuar dhe të koordinuar mirë të të gjitha strukturave në nivel qendror e vendor, medias, shoqërisë civile dhe publikut;

#### **Konstaton se gjatë vitit 2015:**

- Raporti paraqet një vështrim analizues të formave të diskriminimit, bazuar në raportet zyrtare të institucioneve shtetërore, organizatave jofitimprurëse dhe gjetjeve të rezultuara gjatë veprimtarisë së tij.

- KMD-ja ka vijuar veprimtaritë ndërgjegjësuere të shoqërisë, në përgjithësi, dhe grupeve specifike, në veçanti, në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin, organizimin e Ditëve të Hapura, fushatë ndërgjegjësuere në sistemin arsimor, organizimin e tryezave të punës dhe trajnimeve.

- Numri i ankesave të paraqitura pranë KMD-së ka një rritje të pakët, krahasuar me pritshmëritë që ky institucion ka në përmbushje të misionit të tij ligjor dhe në përmbushje të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, ku kërkohej rritja e numrit të ankesave. Në vitin 2015 janë paraqitur 197 ankesa pranë KMD-së, nga 180 të paraqitura në vitin 2014.

- Numri i hetimeve të nisura kryesisht është rritur, krahasuar me vitin 2014.

- Pjesëmarrja e KMD-së në proceset gjyqësore është rritur, krahasuar me vitin 2014.

- Numri i ankesave të referuara nga organizatat jofitimprurëse mbetet i ulët, ndonëse në raport vihen në dukje forcimi i rolit të organizatave, të cilat punojnë për mbrojtjen e të drejtave të grupeve vulnerabël dhe vlerësohet bashkëpunimi i KMD-së me këto organizata.

- Numri i vendimeve të shqyrtuara është relativisht i ulët, krahasuar me numrin e vendimeve për konstatim diskriminimi.

- Numri i ankesave për diskriminim, të regjistruara pranë KMD-së, bazuar në aftësinë e

kufizuar, orientimin seksual, identitetin gjinor dhe gjininë është i ulët.

- KMD-ja ka ofruar mbështetje të nismave ligjore, duke propozuar dy rekomandime legjislative, si dhe ka hartuar një studim, “Mbi situatën e diskriminimit të grave në Shqipëri”.

- KMD-ja ka vazhduar realizimin e monitorimit të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në sektorin privat, në fushën e punësimit, i cili fokusohet në mënyrë të veçantë tek aksesimi i grupeve të dobëta në punësim, si edhe monitorimin e zbatimit të këtij ligji nga gjykatat. Rezultatet e këtyre monitorimeve nuk janë prezantuar në raport, edhe pse janë iniciuar nga KMD-ja që prej vitit 2014 dhe përbëjnë një pikë për t’u përmbushur të rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e KMD-së për vitin 2014.

#### **Kuvendi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2016:**

1. Të vazhdojë veprimtarinë sensibilizuese dhe monitoruese të respektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

2. Të kontribuojë në përmirësimin e legjislacionit, në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe të kontribuojë në rritjen e efektivitetit të zbatimit të tij, nëpërmjet rekomandimeve legjislative drejtuar autoriteteve përgjegjëse.

3. Të vazhdojë përpjekjet për konsolidimin e mëtejshëm të rolit të tij, lidhur me rastet e paraqitura në sistemin gjyqësor.

4. Të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të grupeve të dobëta për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje, duke ndërmarrë fushata informuese, sensibilizuese për çështjet e diskriminimit, në zonat urbane dhe rurale, me qëllim rritjen e identifikimit të rasteve dhe parandalimin e tyre.

5. Të forcojë bashkëpunimin me OJF-të që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht që mbrojnë të drejtat e grupeve të dobëta, me qëllim identifikimin dhe shqyrtimin e rasteve të diskriminimit gjinor, racës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual ose identitetit gjinor, të referuara prej tyre.

6. Të rrisë hetimet e nisura kryesisht.

7. Të monitorojë efektivitetin e ndryshimeve dhe përmirësimeve që ka pësuar kuadri ligjor gjatë vitit 2015 në fushën e barazisë dhe





mosdiskriminimit dhe efektivitetin e tyre në garantimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

8. Të përfundojë monitorimet e zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në sektorin privat, në fushën e punësimit dhe në gjykata dhe të paraqesë gjetjet dhe rekomandimet e tyre, në raportin vjetor të veprimtarisë së KMD-së për vitin 2016.

9. Të rrisë bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Prokurorinë, institucionet publike qendrore dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e masave antidiskriminim, në përputhje me detyrimet ligjore.

10. Të informojë Kuvendin e Shqipërisë, komisionet parlamentare dhe nënkomisionet përkatëse për problematikat dhe shqetësimet që konstatohen gjatë veprimtarisë institucionale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe për rekomandimet legislative që ky institucion i drejton institucioneve shtetërore.

11. Të rrisë transparencën institucionale, përmes pasurimit të faqes zyrtare të institucionit, duke pasqyruar të gjitha aktivitetet dhe veprimtarinë e institucionit, vendimet e ankesave të shqyrtuara, informacione të plota dhe të përditësuara, si dhe të mundësojë portale, forume dhe anketime *online*, të aksesueshme për publikun, me qëllim sigurimin e një komunikimi të vlefshëm, në kohë dhe në interes të qytetarëve.

12. Të ketë një rol më aktiv në mediet kombëtare, vizive dhe të shkruar, me qëllim rritjen e vizibilitetit të këtij institucioni dhe të ndërgjegjësimit të qytetarëve, lidhur me misionin dhe kompetencat ligjore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion i cili shqyrton çështjet e diskriminimit.

Miratuar në datën 28.4.2016

KRYETARI  
**Ilir Meta**

### REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2015

#### Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke pasur parasysh se Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) i

realizon kompetencat e tij lëndore dhe tokësore në gjithë territorin e vendit dhe mbi një numër të konsiderueshëm të pozicioneve të punës;

- Duke marrë parasysh rekomandimet e Delegacionit të Bashkimit Evropian në përfundim të takimit të 5-të dhe të 6-të të Grupit të Posaçëm për Reformën në Administratën Publike, për sigurimin e burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil;

- Duke vlerësuar veprimtarinë e këtij institucioni, si institucion i pavarur, i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij;

- Duke vlerësuar angazhimin e KMSHC-së në përmbushjen e detyrave që i ka ngarkuar ligji, si një nga institucionet me një rol kyç, sa i takon reformës në administratën publike, për një qeverisje të mirë të vendit, si dhe në përmbushjen e pesë prioriteteve për hapjen e negociatave të pranimit në Bashkimin Evropian, në përputhje me parimet e Hapësirës Administrative Evropiane;

- Duke vlerësuar rolin aktiv të KMSHC-së në drejtim të njohjes së ligjit për nëpunësin civil dhe zbatimit sa më uniform të tij nga të gjitha institucionet e përfshira në fushën e veprimit të tij;

- Duke vlerësuar mbështetjen që Komisioneri i ka dhënë administratës së qeverisjes vendore, në drejtim të organizimit të burimeve njerëzore, për të përballuar vështirësitë e paraqitura gjatë procesit të zbatimit të reformës administrativo-territoriale;

**Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2015:**

- Procesi i mbikëqyrjes/inspektimit është standardizuar, nëpërmjet hartimit dhe miratimit të rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”.

- Janë kryer një numër i konsiderueshëm mbikëqyrjesh/inspektimesh të përgjithshme ose tematike, në institucionet që përfshihen në fushën e veprimtarisë së ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në të gjithë territorin e vendit, duke u fokusuar kryesisht në njësitë e qeverisjes vendore, për shkak të reformës administrative-territoriale.

- Janë vlerësuar informacionet e mbërritura pranë këtij institucioni nga nëpunës civilë,



qytetarë të ndryshëm ose të bëra publike në medie, të cilat përmbanin indicie për shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil. Në rastet kur janë konstatuar dyshime të arsyeshme, është kryer procesi i verifikimit, si dhe hetim i thelluar administrativ, duke e zgjidhur çështjen në themel.

- Është realizuar procesi i mbikëqyrjes/inspektimit të orientuar për procedurat e rekrutimit në nivel ekzekutiv, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe procesi i mbikëqyrjes/inspektimit të përgjithshëm, në lidhje me rekrutimin e zhvilluar për nivelin e Trupës së Nëpunësve të Lartë Drejtues (TND), pranë Departamentit të Administratës Publike.

- Ka vijuar ndjekja e zbatimit të vendimeve të paralajmërimit, të nxjerra për të gjitha institucionet e mbikëqyrura, për të cilat ka përfunduar afati ligjor i paralajmërimit.

- Nga ana e subjekteve të ligjit, të cilët i janë nënshtruar procesit të mbikëqyrjes/inspektimit, ka pasur bashkëpunim të mirë me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatimin e detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit.

- Janë hartuar një sërë udhëzimesh për organet e qeverisjes vendore, me qëllim korrigjimin dhe parandalimin e shkeljeve të mëtejshme.

- KMSHC-ja ka luajtur një rol aktiv në drejtim të rregullimit të ligjshmërisë, çka materializohet në një numër të lartë të rasteve, kur nga institucionet është kërkuar nxjerrja e akteve administrative, ndryshimi ose revokimi i tyre.

- KMSHC-ja, duke pasur në konsideratë edhe rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2014”, ka vendosur kontakte dhe ka nisur bashkëpunimin me institucione homologe/“quasi” homologe, apo organizata ndërkombëtare, në rajon dhe më gjerë, të cilat operojnë në fushën e administratës publike.

- KMSHC-ja ka bërë publike në faqen e saj zyrtare të internetit çdo vendimmarrje të këtij institucioni, në përmbushje të kompetencave që i ka ngarkuar ligji, duke zbatuar programin e transparencës dhe informimit të publikut.

**Për vitin 2016, Kuvendi i Shqipërisë kërkon nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil:**

1. Të vazhdojë të përmbushë misionin e tij ligjor për garantimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në administrimin e shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet, moral dhe paanësi politike, duke pasur në vëmendje edhe rekomandimet e Raport-progresit të BE-së për vitin 2015.

2. Të planifikojë me efektivitet numrin e mbikëqyrjeve/inspektimeve të përgjithshme ose tematike në institucionet që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke u kujdesur që të përfshihen në to të gjitha institucionet që janë pjesë e sistemit të shërbimit civil, me qëllim që të sigurohet një mbulim sa më i gjerë i tyre dhe një kontroll sa më i madh, në lidhje me situatën e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

3. Të vijojë procesin e nisur të mbikëqyrjes orientuese pranë DAP-it, në lidhje me rekrutimet e reja në nivelin ekzekutiv dhe trupën e lartë drejtuese, duke e zgjeruar më tej monitorimin edhe në drejtim të zhvillimit të sistemit të karrierës, që përfaqësohet me ngritjen në detyrë dhe lëvizjen paralele, me qëllim që të sigurohet transparenca e procesit dhe zbatimi i procedurave ligjore, të cilat rrisin besimin e publikut e, për pasojë, nxisin pjesëmarrje të gjerë edhe rritjen e nivelit të cilësisë për prurjet e reja.

4. Mbikëqyrja orientuese në fushën e rekrutimit të përfshijë edhe institucionet e administratës vendore, me qëllim që të mundësohet eliminimi i parregullsive të konstatuara dhe të përafrohen standardet e procesit me ato të aplikuar nga Departamenti i Administratës Publike.

5. KMSHC-ja duhet të gjejë mjetet e duhura për të nxitur administratën vendore, për të bashkëpunuar ngushtë me Departamentin e Administratës Publike, në drejtim të mundësisit të përdorimit të aspekteve të veçanta të sistemit të rekrutimit, të tilla si banka elektronike e pyetjeve, tashmë të krijuar prej DAP-it, të përdorë listën e ekspertëve të konkurrimit, me pedagogë të fushës, të mundësohet punësimi i kandidatëve të regjistruar në listën e kandidatëve fitues të DAP-it, të cilët nuk mund të emërohen



pas konkurrencimit, për arsye të ndryshme, si dhe në aspekte të tjera, ku është e mundur.

6. Të vijojë praktikën e verifikimit dhe më tej, të hetimit administrativ, në lidhje me informacionet për shkelje të ligjit, të cilat i adresohen KMSHC-së nga nëpunës civilë, si dhe nga të gjitha burimet e tjera, të tilla, si mediet, apo qytetarët e interesuar për miradministrimin e shërbimit civil.

7. Të vijojë puna me përmbylljen e procesit të mbikëqyrjes, nëpërmjet verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese, nga subjektet që i janë nënshtruar procesit të kontrollit kryesisht, ose të planifikuar, si dhe të rasteve, kur është vepruar pas indicieve të marra prej informacioneve për parregullsi në fushën e administrimit të shërbimit civil dhe, nëse është e nevojshme, të përdorë të gjitha mjetet ligjore për të siguruar zbatimin e tyre.

8. Të vijojë t'i ofrojë mbështetje dhe asistencë teknike njësisve të administrimit të burimeve njerëzore, në të gjithë sistemin e shërbimit civil, për të rritur kapacitetet e tyre dhe për të sjellë në vëmendjen e drejtuesve të institucionit rëndësinë thelbësore që ka miradministrimi i burimeve njerëzore në arritjen e objektivave të tyre, drejt modernizimit të shërbimit ndaj qytetarëve dhe rritjen e cilësisë së tij.

9. Në kushtet e përgatitjes së strukturave definitive të institucioneve të riformatuara të administratës vendore, në vijim të aplikimit të reformës territoriale, për të siguruar një administrim të mirë të burimeve njerëzore në këtë rast, në zbatim të ligjit për nëpunësin civil, Komisioneri duhet të luajë një rol aktiv për të ndihmuar në rritjen e nivelit të bashkëpunimit midis të gjitha institucioneve, në pjesën që ka të bëjë me shërbimin civil, duke nisur me ato qendrore shtetërore, të cilat orientojnë reformën, si dhe agjencitë e krijuara për të asistuar reformën.

10. Për të realizuar rolin e tij si mbikëqyrës i funksionimit të sistemit të shërbimit civil dhe në kuadër të rritjes së kapaciteteve institucionale, të mundësojë krijimin e një sistemi të mbikëqyrjes dixhitale efikas, dinamik, që ndjek në kohë reale çdo ndryshim ose lëvizje, çdo vlerësim ose procedim disiplinor, me qëllim parandalimin e shkeljeve dhe pakësimin e kostove sociale dhe financiare në Buxhetin e Shtetit, të cilat janë rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit.

11. Të zgjerojë kontaktet dhe të rrisë bashkëpunimin me institucione të ngjashme në

rajon dhe më gjerë, në mënyrë që të përfitojë sa më shumë nga përvoja e tyre, në funksion të përmbushjes së misionit të tij dhe arritjes së standardeve evropiane.

12. T'i propozojë Kuvendit ndërhyrje ligjore, nëse gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ka nevojë për ndryshime.

Miratuar në datën 28.4.2016

KRYETARI  
Ilir Meta

### REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË  
INSPEKTORATIT TË LARTË TË  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË  
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË  
INTERESAVE PËR VITIN 2015

#### Kuvendi i Shqipërisë:

Duke konsideruar luftën kundër korrupsionit si prioritetin kyç për forcimin e shtetit të së drejtës, zhvillimin ekonomik e social të vendit, si dhe një ndër kushtet thelbësore për integrimin e mëtejshëm të vendit për anëtarësim në BE;

Duke vlerësuar rolin thelbësor të ILDKPKI-së në zbulimin dhe marrjen e masave administrative për shkeljet e ligjit të konfliktit të interesit dhe deklarimit të pasurive, si dhe referimin për ndjekje penale të rasteve të korrupsionit në përgjithësi dhe më në veçanti në atë të pasurive të paligjshme, në radhët e funksionarëve të lartë të shtetit, administratës publike, sistemit gjyqësor dhe atij të akuzës, si dhe një sërë subjektesh të tjera të ligjit;

Duke theksuar se integriteti, pavarësia dhe zbatueshmëria e ligjit në mënyrë të paanshme dhe transparente nga ky institucion, krahas bashkëveprimit me të gjitha institucionet ligjzbatuese në vend, janë faktorët kryesorë për arritjen e rezultateve të prekshme në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, për forcimin e shtetit ligjor;

Duke inkurajuar e mbështetur institucionin e ILDKPKI-së, si organi kyç në luftën anti-korrupsion, me forcimin e kapaciteteve administrative e financiare dhe të instrumenteve ligjore, me qëllim përmbushjen e misionit ligjor institucional për zbulimin e pasurimit korruptiv dhe praktikave të ngjashme me të, si dhe në parandalimin e konfliktit të interesit;

**Konstaton dhe vlerëson se ILDKPKI-ja për vitin 2015:**

- Performanca e ILDKPKI-së gjatë vitit 2015 ka rritje pozitive të mëtejshme në funksionimin tërësor institucional, në zbatimin e detyrimeve në afatet e caktuara ligjore, duke përmbushur objektivat thelbësorë të tij.

- ILDKPKI-ja ka përmbushur objektivat e pritshëm, të përcaktuar në rezolutën e Kuvendit, të lëna për vitin 2015, si dhe rekomandimet e GRECO-s.

- Ka arritur një sërë rezultatesh konkrete në të tria llojet e kontroleve dhe hetimit administrativ, lidhur me zbulimin e fshehjeve të pasurisë, si dhe në zbulimin e shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave private, duke vijuar me vendosjen e sanksioneve përkatëse penale dhe veprimeve të tjera administrative.

- Ka dërguar para organit të akuzës, me rekorde rritëse në krahasim me vitin 2014, një numër prej 84 kallëzimesh penale, si dhe ka ndëshkuar një numër të madh zyrtarësh, duke vendosur një numër të lartë prej 550 masash administrative me gjobë për rastet konkrete të hetuara.

- Ka pasur fokus kontrollin dhe kapjen e zyrtarëve të niveleve të larta, të cilët janë dërguar për ndjekje penale për pasuri të fshehura e të pajustificuara me burime të ligjshme financiare, të cilat kapin vlerën në total të rreth 40 milion eurove.

- Ka punuar intensivisht me autoritetet përgjegjëse, duke asistuar ato me konsulencë ligjore e teknike, si dhe ka kryer trajnime dhe kontrole në institucionet publike, me qëllim evidentimin dhe trajtimin e konfliktit rast për rast, si dhe parandalimin e ndëshkimit të rasteve të konfliktit të vazhdueshëm të interesave.

- Miratimi i shtesave në strukturë dhe shtimi i fondeve buxhetore kanë ndikuar në përmirësimin e kapaciteteve investiguese dhe rritjen e forcës kontrolluese e goditëse, duke fuqizuar imazhin institucional si organ kontrolli antikorrupsion.

- Ka vazhduar bashkëveprimin ndër-institucional në nivel bilateral dhe multilateral me nënshkrimin e memorandumeve të reja, duke synuar rritjen e shpeshësisë së shkëmbimit të informacionit për çështje të luftës kundër korrupsionit, parandalimit të pastrimit të parave dhe krimit të organizuar.

- Ka ndjekur dhe realizuar një politikë të hapur të transparencës institucionale, duke rritur besimin e komunikimin me publikun dhe me median, duke publikuar me kërkesë, si asnjë vit tjetër, rreth 7 000 deklarata të interesave private për subjekte të ndryshme deklaruese.

Kuvendi i Shqipërisë vëren me shqetësim problematikën e raportuar në vazhdimësi nga ILDKPKI-ja në bashkëveprimin dhe marrëdhëniet institucionale me organin e akuzës për hetimin dhe dërgimin e çështjeve të referuara nga ILDKPKI-ja në gjykim.

Monitorimi i çështjeve të konfliktit të interesave, evidentimi i këtij konflikti përmes dhënies së aksesit të drejtpërdrejtë në *database*-n elektronike në institucionet kyçe, për konstatimin e rasteve, është jo vetëm një sfidë ligjore, por dhe e lidhur me shumë faktorë të tjerë jo detyruesisht të varura nga ky institucion.

**Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2016, kërkon nga ILDKPKI-ja të ketë në fokus të punës së saj:**

- Garantimin e forcimit të pavarësisë dhe integritetit institucional dhe vazhdimin me vendosmëri të luftës kundër korrupsionit, në radhët e administratës publike në përgjithësi, por më veçanërisht në radhët e zyrtarëve të lartë, gjyqtarë dhe prokurorë.

- Forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve investiguese me fokus të veçantë trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe zbatimin e një politike efektive masash për çdo rast të lidhur me to.

- ILDKPKI-ja gjatë vitit 2016 të ushtrojë të drejtën për ankim, bazuar në Kodin e Procedurës Penale, lidhur me vendimet e mosfillimit të procedimit penal dhe pushimit të çështjes nga organi i akuzës.

- Fokusimin me drejtim të sigurimit të aksesit të drejtpërdrejtë në *database*-n elektronike në institucionet kyçe, për konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave dhe evidentimit të ndryshimeve të nevojshme nëse legjislacioni aktual ka qenë pengesë për mosrealizimin e këtij rekomandimi në të shkuarën.

- Finalizimin dhe përcjelljen për miratim të projektpropozimeve për disa shtesa dhe ndryshime në ligjet bazë të organizimit dhe funksionimit të ILDKPKI-së, përkatësisht ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e



pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, me miratimin e paketës së reformës në drejtësi, e cila pritet që jo vetëm të ndryshojë, por edhe të krijojë institucione të reja kushtetuese, zyrtarët e të cilave do të përfshihen në kategorinë e subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim të interesave private.

- Fillimin e përgatitjeve, përcaktuar në ligjin e ri “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, si dhe përcjelljen e propozimit nga ILDKPKI-ja për burime financiare e njerëzore, sipas zhvillimit të procedurave buxhetore për t’u miratuar në Kuvend, me qëllim mundësimin për zbatimin efikas të ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

- Vazhdimin e ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile. Forcimin e mëtejshëm të urave të bashkëpunimit me median investigative. Respektimin e mekanizmave informues ligjorë e publikë, duke respektuar ligjin për të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale, për publikimin e deklaratave të interesave private.

- Përmirësimin e sistemit aktual për plotësimin, administrimin dhe kontrollin e formularëve të deklaramit, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës të Inspektoratit të Lartë, duke shkuar drejt deklaramit *online*, me mbështetjen e donatorëve dhe ekspertizës së huaj.

- Kuvendi nxit dhe mbështet ILDKPKI-në në forcimin e bashkëpunimit me zyra homologe dhe institucione të tjera jashtë vendit, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave, praktikave më të mira apo informacioneve që synojnë zgjerimin e hapësirave investigative të hetimit të pasurive të fshehura apo të padeklaruara të zyrtarëve jashtë vendit.

Miratuar në datën 5.5.2016

KRYETARI  
I Ilir Meta

## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2015

Kuvendi i Shqipërisë e vlerëson Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri një institucion publik dhe të pavarur, i cili ka një rëndësi të veçantë për trajtimin e periudhës së regjimit komunist.

Duke konsideruar veprimtarinë kërkimore, studimore e sensibilizuese të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri si një mekanizëm të transparencës dhe pasurimit të historisë kombëtare;

Duke vlerësuar lidhjet bashkëpunuese me institucione shkencore brenda vendit, organizma të interesuar për veprimtarinë e Institutit dhe me institutet e ngjashme të kujtesave kombëtare në Evropë.

**Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi raportin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri mbi veprimtarinë në vitin 2015. Në trajtimin çështjeve të ngritura për:**

- Bashkëpunimin që është zhvilluar me institucionet vendase dhe të huaja në funksion të qëllimit të Institutit;

- Kërkimet në arkiva, duke studiuar dhe përcaktuar ekspertizën e çështjeve të lidhura me periudhën e regjimit komunist;

- Mbledhjen në të gjithë vendin të dëshmimeve të të mbijetuarve nga burgjet e komunizmit, nëpërmjet dëshmimeve gojore e dokumentare të drejtpërdrejta;

- Bashkëpunimin me Institutin e Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë dhe shoqatat e të përndjekurve politikë në nisjen e një projekti të regjistrimit të saktë të qytetarëve të pushkatuar pa gjyq gjatë regjimit komunist, emrat e të cilëve nuk gjenden në asnjë arkiv;

**Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se:**

Në vitin 2015 Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri ka organizuar një sërë aktivitetesh shkencore dhe përkujtimore kombëtare e ndërkombehtarë dhe është në proces të pasurimit të arkivit të tij. Ky arkiv është hapur për studimet dhe shfrytëzimin e materialit të tij nga studiuesit e botës akademike dhe përbën një bazë të mirëfilltë të literaturës



shkencore për trajtimin e periudhës së regjimit komunist.

Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri ka vendosur dhe ka konsoliduar marrëdhëniet e bashkëpunimit institucional me drejtoritë e arkivave të institucioneve në vend, duke vazhduar punën për mbledhjen e dokumenteve të profilit të tij.

Botimi i kolanës “Ad Memorandum” është një i akt të rëndësishëm publik. Aty përfshihen 11 vëllime me studime monografike, të bazuara në arkivat e shtetit e dokumente origjinale, si edhe me memoristikën e intelektualëve që kanë përjetuar burgjet e përndjekjet e regjimit komunist. Kjo kolanë u prezantua më 29 janar 2016.

Bashkëpunimi me institucionet e rëndësishme shkencore dhe Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri ka arritur një nivel të ri me firmosjen për herë të parë të marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve të një platforme të përbashkët për njohjen e nxënësve të shkollave dhe gjimnazeve me faktet dhe të vërtetat regjimit komunist.

Përfundimi i punës në terren, për të evidentuar burgjet dhe kampet e punës së detyruar nëpër gjithë territorin e Shqipërisë, do të realizojë një hartë të saktë të këtij sistemi vendndodhësh.

Nisja e punës për bashkëpunimin me qendra të ndryshme universitare kërkimore-shkencore dhe projekte speciale për dokumentarë të shkurtër monografikë televizivë do të transmetojë informacion realist rreth aspekteve të përndjekjes dhe shtypjes së lirive qytetare gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

Vijimi i përkrahjes dhe nxitjes së studimeve shkencore rreth krimeve të komunizmit me doktorantë të huaj e shqiptarë pranë universiteteve të Evropës e Amerikës, duke u afruar atyre dokumentet dhe literaturën e nevojshme dhe konsulencën shkencore në këtë drejtim, ka sjellë gjatë vitit 2015 një fluks studentësh që janë paraqitur për të shfrytëzuar arkivat dhe literaturën e institutit.

**Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Institutit i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri fokusimin në:**

- Angazhimin në vazhdimësi për studimin dhe vlerësimin objektivisht të periudhës së regjimit komunist, duke hulumtuar arkivat e akteve ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përga-

titura apo të miratuara nga institucionet, organet e autoritetet shtetërore, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të regjimit komunist;

- Studimin dhe vlerësimin e mënyrës së ndërtimit, organizimit institucional dhe veprimtarinë e strukturave shtetërore gjatë periudhës së regjimit komunist, duke analizuar krimet e kryera gjatë periudhës së komunizmit;

- Grumbullimin e të dhënave, dokumenteve dhe dëshmimeve për veprimtarinë e organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;

- Sistemimin dhe katalogimin e kujtimeve të të dënuarve politikë dhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit dhe krijimin e një regjistri elektronik për përpunimin e të gjithë dokumentacionit për krimet e regjimit komunist në Shqipëri.

Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri studim objektiv të periudhës së regjimit komunist, të dokumenteve që vërtetojnë përfshirjen e personave shqiptarë a të huaj në mbështetje të krimeve të regjimit komunist në Shqipëri, si dhe të atyre, të cilët bënë rezistencë kundër këtij regjimi.

Kuvendi i Shqipërisë konsideron të rëndësishme vendosjen në dispozicion Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri hapësirat e nevojshme të punës (sipas VKM-së nr. 189, datë 9.3.2011), ose të shihet mundësia e sistemimit të këtij institucioni në një godinë, e cila të përmbushë normalisht funksionet e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson si të nevojshme vendosjen në eficiencë të marrëveshjes së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në forcimin e bashkëpunimit të tij me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore, vendase dhe huaja, për qëllimet dhe objektivat e vitit 2106.

Miratuar në datën 5.5.2016

KRYETARI  
Ilir Meta

**DEKRET**

Nr. 9554, datë 3.5.2016

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË  
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Arsimit dhe Sportit,

**DEKRETOJ:****Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Shpend Ali Ahmeti
2. Berat Bashor Buzhala
3. Mimoza Adem Kusari Lila (Kusari)
4. Frédéric (Frederik) Shtjefan Veseli
5. Qëndresa Brahim Krasniqi
6. Visar Shaban Tafaj
7. Meriton Byrhan Siqeca

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**RREGULLORE**

Nr. 1, datë 22.4.2016

**MBI FUNKSIONIMIN E KOMITETIT PËR  
KOORDINIMIN E KËRKIMIT  
SHKENCOR, TEKNIK DHE EKONOMIK  
PËR PESHKIMIN DHE AKUAKULTURËN**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 20, të pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, miraton këtë rregullore mbi funksionimin e Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik për Peshkimin dhe Akuakulturën.

**Neni 1****Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e funksionimit të Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik për Peshkimin dhe Akuakulturën.

**Neni 2****Përbërja e Komitetit**

Anëtarët e Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik caktohen me urdhër të ministrit, në të cilin marrin pjesë shkencëtarë dhe personalitete të njohura në fushën e peshkimit, akuakulturës dhe mjedisit, me këtë përbërje:

1. Sekretari i përgjithshëm ose zëvendësministri që mbulon peshkimin (kryetar);
2. Drejtori që mbulon peshkimin (zëvendëskryetar);
3. Drejtori që mbulon shërbimet në fushën e peshkimit dhe akuakulturës (anëtar);
4. Përfaqësues nga Drejtoria e Peshkimit dhe Akuakulturës (3 anëtarë);
5. Koordinator/përgjegjësi i laboratorit për peshkimin dhe akuakulturën (1–2 anëtarë);
6. Përfaqësues nga institucione të tjera që lidhen me peshkimin dhe akuakulturën (2–3 anëtarë);
7. Specialistë në lëmin e peshkimit dhe të akuakulturës (2 anëtarë);
8. Personalitete të njohura, studiues në fushën e peshkimit dhe akuakulturës (2–3 anëtarë).

**Neni 3****Kohëzgjatja**

Anëtarët e Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik, kanë një mandat tre–katërvjeçar.

**Neni 4.****Detyrat e Komitetit për Koordinimin e  
Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik**

Komiteti për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik është organ këshillimor dhe konsultativ i përhershëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për çështje që lidhen me studimet e kërkimit me interes shkencor, teknik, shtetëror dhe ekonomik në fushën e peshkimit dhe akuakulturës dhe ka për qëllim:

1. Koordinimin e kërkimit dhe vlerësimit të popullatës së peshqve;
2. Koordinimin e monitorimit të kushteve dhe vlerësimet e kushteve në lidhje me shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve peshkore dhe organizmave të tjerë detarë;



3. Koordinimin e përgatitjes së bazës profesionale për Planin Strategjik Kombëtar, Planin e Menaxhimit dhe Planin e Zbatimit të Peshkimit;

4. Koordinimin dhe përcaktimin e termave teknikë dhe teknologjikë për të gjitha llojet e peshkimit;

5. Dhënie asistence apo opinioni, hartim termash reference për autorizime të ndryshme në fushën e peshkimit dhe/apo akuakulturës;

6. Koordinimit e dhënies së asistencës profesionale në aktivitetin e peshkimit, diskutimit mbi gjendjen e sektorit ose probleme të ndryshme të tij, sipas kërkesës së kryetarit.

Kryetari i komisionit mbi bazën e diskutimeve dhe të votimit eventual merr vendimin përkatës mbi çështjet e diskutuara dhe të propozuara për zgjidhje.

Neni 5

#### **Mbledhja e Komitetit**

1. Komiteti për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik, mbledhet sa herë që kryetari e sheh të arsyeshme por sidoqoftë jo më pak se njëherë në vit.

2. Mbledhjet e Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik për Peshkimin dhe Akuakulturën thirren dhe drejtohen nga kryetari i Komitetit dhe në mungesë të tij nga nënkryetari, me autorizim të kryetarit.

3. Mbledhja e Komitetit kërkon praninë e 50% plus 1 të numrit të anëtarëve.

4. Kryetari mund të ftojë në mbledhje, por pa të drejtë vote, drejtues apo ekspertë të tjerë nga MBZHRAU-ja, nga institucione të tjera qendrore, nga shoqatat e peshkatarëve, nga institucione të kërkimit shkencor, përfaqësues të donatorëve që kanë lidhje me çështjet e paraqitura për diskutim në mbledhjen e Komitetit.

5. Mbledhjen e Komitetit për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik (KKSHTË) e drejton kryetari. Ai përcakton radhën e shqyrtimit të çështjeve sipas rendit të ditës, rregullat e zhvillimit të debatit, procedurën e votimit nëse lind e nevojshme. Në fund të mbledhjes kryetari deklaron mbylljen e saj. Kur një ose disa çështje sipas rendit të ditës nuk arrijnë të shqyrtohen brenda ditës së mbledhjes ai vendos vazhdimin e mbledhjes në një ditë tjetër

ose përfshirjen e tyre në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme.

6. Për mbarëvajtjen dhe dokumentimin e mbledhjes mbahet procesverbali i mbledhjes së KKSHTË-së, i cili si rregull bëhet nga Sekretari i Komitetit.

Neni 6

#### **Sekretari i Komitetit**

Një specialist i Drejtorisë së Peshkimit caktohet sekretar i KKSHTË-së, i cili:

1. Verifikon nëse materialet e paraqitura për mbledhjen e Komitetit janë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;

2. I paraqet kryetarit materialet e përgatitura për mbledhjen e Komitetit;

3. I dërgon anëtarëve të Komitetit, mbas miratimit, materialet dhe njoftimin përkatës për mbledhje e ardhshme;

4. Përgatit, mbas mbledhjes, materialin përfundimtar me konkluzionet e saj, prioritetet, vërejtjet, detyrat e përcaktuara dhe vendimet.

Neni 7

#### **Përgatitja e materialeve dhe paraqitja e tyre për shqyrtim**

1. Të drejtën për të paraqitur materiale për shqyrtim në mbledhjen e KKSHTË-së e kanë kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e Komitetit;

2. Materialet mund të jenë të karakterit raportues e informues periodik, ose propozime konkrete, të cilat kryetari i shtron për mendim;

3. Kryetari mund të kërkojë që, për disa çështje të diskutuara në mbledhje, të kalohet në votim.

4. Materialet, për të cilat kërkohet diskutim, duhet të përmbajnë:

a) një relacion shpjegues;

b) dokumentin që duhet të vlerësohet.

5. Rendi i ditës përgatitet nga nënkryetari dhe miratohet nga kryetari;

6. Mbas miratimit sekretari i KKSHTË-së u dërgon njoftimin anëtarëve të KKSHTË-së, i cili përmban:

a) kohën dhe vendin ku do të zhvillohet mbledhja;

b) çështjet kryesore të rendit të ditës;

c) materialet që do të shqyrtohen.

7. Njoftimi i mbledhjes, si dhe materialet përkatëse duhet t'u dërgohen anëtarëve të KKSHTË-së jo më vonë se një javë para datës së çdo mbledhjeje.





Neni 8

**Procedurat e zhvillimit të mbledhjes**

1. Mbledhja hapet nga kryetari, i cili fton të gjithë anëtarët e KKSHTE-së të drejtojnë pyetje ose të kërkojnë sqarime mbi materialet e paraqitura në komision, gjithmonë duke respektuar rendin e ditës. Mbas sqarimit të pyetjeve, kalohet në diskutime.

2. Në rastet kur një anëtar nuk merr pjesë në mbledhje, por njihet paraprakisht me materialet e mbledhjes dhe dëshiron të shprehet për to, ai mund të depozitojë mendimin e tij me shkrim te sekretari i Komitetit.

3. Në fund të mbledhjes kryetari i KKSHTE-së merr vendimin/et përkatëse për çështjet e diskutuara.

Neni 9

**Përgatitja dhe marrja fuqi e vendimeve**

1. Zbardhja e vendimeve bëhet nga sekretari i KKSHTE-së brenda tri ditëve nga përfundimi i mbledhjes.

2. Vendimet e Komitetit qarkullojnë me firmën e kryetarit që drejton mbledhjen. Një kopje e këtij vendimi ruhet në arkivin e materialeve të Komitetit.

Neni 10

**Dokumentimi i mbledhjeve**

1. Dokumentimi i mbledhjeve bëhet nga Sekretari i Komitetit me anë të procesverbaleve.

Në procesverbal duhet të pasqyrohet:

- Pjesëmarrja e anëtarëve të KKSHTE-së dhe e të ftuarve të tjerë në mbledhje;
- Diskutimet, propozimet, pyetjet, vërejtjet, sugjerimet etj. që janë bërë në mbledhje;
- Vendimi i marrë nga kryetari.

2. Në rastet kur mungon sekretari kjo detyrë bëhet nga një punonjës tjetër i drejtorisë, me vendim të drejtuesit të mbledhjes.

Neni 12

**Shfuqizimet**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, rregullorja nr. 1, datë 13.12.2004, “Mbi funksionimin e komitetit për koordinimin e kërkimit shkencor, teknik dhe ekonomik për peshkimin dhe akuakulturën”, shfuqizohet.

MINISTRI I BUJQËSISË,  
ZHVILLIMIT RURAL DHE  
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE  
**Edmond Panariti**

VENDIM

Nr. 24, datë 25.4.2016

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 1.3.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 75/29 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Klement Fejzaj, përfaqësuar në gjykim me prokurë të posaçme nga avokate Shega Ligori.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Serri Xhindi, përfaqësuar në gjykim me prokurë të posaçme nga avokat Arben Rakipi.

Barjam Fejzaj, në mungesë.

Ramiz Aliraj, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 610, datë 12.6.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2015-1109, datë 16.4.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4/1, 5, 42, 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.12.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; neni 6/1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Serri Xhindit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



## VËREN:

## I

1. Palët ndërgjyqëse janë bashkëfshatarë nga fshati Kaninë, Vlorë. Subjekti i interesuar Serri Xhindi, duke pretenduar se kërkuesi ka filluar një ndërtim të paligjshëm brenda sipërfaqes së tokës në pronësi të familjes Xhindi, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesë-padi me objekt lirim e dorëzim sendi.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1270, datë 31.5.2011, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, mbi ankimin e subjektit të interesuar Serri Xhindi, me vendimin nr. 610, datë 12.6.2012, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt ka përcaktuar detyrimin e kërkuesit dhe të subjekteve të interesuara Bajram Fejzaj dhe Ramiz Aliraj t'i lirojnë subjektit të interesuar Serri Xhindi sipërfaqen e tokës prej 2.150 m<sup>2</sup> sipas aktit të ekspertimit.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-1109, datë 16.4.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

## II

5. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese. Ai pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

5.1. Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi kërkuesi e ka poseduar për 20 vjet në mënyrë të pandërprerë dhe pa shqetësim pronën.

5.2. Është cenuar e drejta e aksesit dhe e ankimit efektiv, sepse Gjykata e Lartë edhe pse në prezencë të dy vendimeve gjyqësore me qëndrime të ndryshme, nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit.

5.3. Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, sepse Gjykata e Lartë duke mos e arsyetuar vendimin e saj, nuk ka ushtruar funksionin e kontrollit të zbatimit të ligjit.

5.4. Është cenuar parimi i barazisë së armëve, sepse Gjykata e Apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit. Kjo shkelje nuk është korrigjuar as nga Gjykata e Lartë.

5.5. Është cenuar standardi i arsytimit të vendimit, sepse vendimi i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës së Lartë nuk janë të arsyetuar.

5.6. Është cenuar parimi i ligjshmërisë, pasi gjykatat kanë vlerësuar dhe konsideruar falsifikimin si gabim material.

5.7. Gjykata e Lartë në raste analoge ka mbajtur qëndrim të kundërt për aktin e falsifikuar.

6. **Subjekti i interesuar**, Serri Xhindi, ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur se:

6.1. Kërkuesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe atij të barazisë së armëve, sepse nuk i ka parashtruar këto pretendime në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë.

6.2. Vendimet e gjykatave nuk kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, pasi nuk jemi në kushtet e mosrespektimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë apo përpara një vendimi të prokurorisë për deklarimin e falsitetit të dokumentit.

6.3. Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga KPC-ja dhe jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e vendimit.

6.4. Edhe vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i ka përmbushur elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese dhe KPC-ja lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, sepse ai përmban shkaqet e rekursit dhe arsyen e mospranimit të tij. Sipas jurisprudencës kushtetuese arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimi nuk e cenon procesin e rregullt ligjor.

6.5. Gjykatat nuk e kanë cenuar parimin e barazisë së armëve, sepse kërkuesi ka paraqitur prova, ka debatuar për ekspertimet dhe ka paraqitur prapësime. Pretendimet e tij lidhur me këtë parim, përkundrazi, kanë të bëjnë me kundërshtimin e arsytimit të vendimeve, pasi kërkuesi nuk argumenton për mospasjen e mundësisë për të paraqitur argumentet dhe deklarimet e tij për faktet dhe provat.

6.6. Pretendimi i kërkuesit për shkeljen e parimit të ligjshmërisë dhe trajtimit të barabartë ka të bëjë me interpretimin e neneve 246, 248 e vijues të KPC-së, çka nuk hyn në juridiksionin kushtetues.



### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuësit

7. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi pretendimet e tij janë paraqitur brenda afatit ligjor dyvjeçar të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

8. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materia* Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte, çka nënkupton se kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin në shqyrtim, bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i subjektit të interesuar se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, është i pabazuar. Nga materialet e kësaj çështjeje, siç do të arsyetohet në vijim në vendim, rezulton se kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, ku ka ngritur edhe pretendimet e tij lidhur me procesin civil të zhvilluar nga gjykatat e faktit. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimet objekt shqyrtimi.

10. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuësit *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të së drejtës së ankimit

11. Kërkuesi pretendon se vendimi i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës së Lartë nuk janë të arsyetuar dhe se Gjykata e Lartë edhe pse e ndodhur para faktit të dy vendimeve gjyqësore me qëndrime diametralisht të kundërta, nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij, duke i cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial.

12. Gjykata vëren se lidhur me cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë argument kushtetues, prandaj Gjykata do të ndalet në shqyrtimin e pretendimeve të lartpërmendura vetëm në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë.

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme



detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërtënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për gjykimin në Gjykatën e Lartë, sipas KPC-së (nenet 472 e në vijim), rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet, dhe shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Gjykata në këtë drejtim ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit Civil/Penal (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së Lartë ushtrimin e kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Gjykata ka theksuar se standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi. Rekursi është i vetmi mjet procedural në dispozicion të kërkuarit, me anë të të cilit ai mund të ketë akses në Gjykatën e Lartë, duke e investuar këtë të fundit me shqyrtimin e pretendimeve të tij (*shih vendimin nr. 9, datë 15.3.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se dy gjykata të niveleve të ndryshme, ajo e shkallës së parë dhe ajo e apelit, i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta zgjidhjes së konfliktit *de quo*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka arritur në përfundimin se pretendimi i subjektit të interesuar Serri Xhindi (palë paditëse në atë gjykim) se ndërtimi i kërkuarit ndodhet brenda sipërfaqes së tokës në pronësi të familjes Xhindi, nuk mbështetet në provat e administruara në gjykim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë arsyetimin e saj e ka bazuar në aktin e ekspertimit kriminalistik, nga i cili rezulton se në aktin e marrjes së pronësisë së subjektit të interesuar

Serri Xhindi ka korrigjime në disa rreshta, si dhe në aktin e ekspertimit topografik, sipas të cilit pronat e palëve ndërgjyqëse kanë mbivendosje, e cila shmanget nëse nuk do të ekzistonin korrigjimet në aktin e marrjes së pronësisë. Ndërsa, Gjykata e Apelit Vlorë në marrjen e vendimit nuk ndalet mbi thelbin e mosmarrëveshjes, që ka të bëjë me faktin se në pronësinë e cilës prej palëve ndërgjyqëse ka filluar ndërtimi, por është mjaftuar vetëm me vlerësimin e korrigjimeve të aktit të marrjes në pronësi të subjektit të interesuar, që sipas saj janë thjesht “lapsuse”. Gjykata e Apelit Vlorë, duke mos e konsideruar aktin e ekspertimit topografik, përfundimin e saj e bazon në faktin se korrigjimet në aktin e marrjes së tokës në pronësi të subjektit të interesuar janë të konfirmuara në dokumentet e disa prej organeve shtetërore (komuna Qendër dhe kadastra Vlorë), por që nuk rezultojnë të jenë thirrur prej saj si palë në gjykim.

18. Në këto kushte, kërkuari për zgjidhjen e problemit i është drejtuar Gjykatës së Lartë, duke kërkuar prej saj, si gjykatë më e lartë, të bëjë rolin e “arbitrit” ndaj vendimeve të shkallëve më të ulëta. Pretendimeve të kërkuarit Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përgjigjet me një vendim standard formal mospranimi të rekursit, i cili nuk përmban asnjë arsyetim jo vetëm për të kuptuar shkaqet e këtij qëndrimi, por edhe për ta përligjur vendimmarrjen e tij, pavarësisht se arsyetimi i vendimit (qoftë edhe me një argumentim të shkurtuar të pretendimeve) është detyrim kushtetues që buron nga neni 142/1 i Kushtetutës dhe KPC-ja.

19. Gjykata është shprehur se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të cilat janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit, që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).



20. Në këtë drejtim edhe pse interpretimi i ligjit material e procedural dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete nuk hyn në juridiksionin kushtetues, Gjykata vlerëson se në një shtet të së drejtës roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i pazëvendësueshëm. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat që të marrë një rol aktiv, i cili shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, duke përfshirë këtu, veç të tjerave, edhe të drejtën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të marrë vendime për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

21. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë rast pas rasti duhet t'u japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit. Sipas gjykatës në të tilla raste kërkuesit, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 4, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'u drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë,

duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkallim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile/penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimin nr. 6, datë 10.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Bazuar në sa më lart, si dhe duke pasur parasysh edhe problemet e lidhura me disponimet e pasurive të paluajtshme të fituara në vite, në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë nuk i ka shqyrtuar në themel pretendimet e kërkuesit lidhur me mangësitë e vendimit të Gjykatës së Apelit, duke i mohuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial në këndvështrim të së drejtës për të pasur një vendim përfundimtar që do t'u jepte përgjigje pretendimeve të tij.

*C. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike*

25. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, kërkuesi parashtron se ai e ka poseduar pronën për 20 vjet në mënyrë të pandërprerë dhe pa shqetësim në bazë të një akti që nuk është i falsifikuar.

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për



gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë. Vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa më sipër, Gjykata çmon se në rastin në shqyrtim, përderisa pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk lidhet me ekzistencën e ndonjë vendimi të formës së prerë, ky pretendim është haptazi i pabazuar.

*Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj*

28. Kërkuesi, gjithashtu, pretendon se është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj, sepse Gjykata e Lartë duke mos e arsyetuar vendimin e saj nuk ka ushtruar funksionin e kontrollit të zbatimit të ligjit.

29. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “gjykatë e caktuar me ligj”. Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata çmon se në rastin në shqyrtim, përderisa Gjykata e Lartë është gjykata kompetente për të shqyrtuar çështjen në fjalë, fakti që ajo e ka shqyrtuar atë në dhomën e këshillimit nuk do të thotë se ka cenuar elementet e parimit të gjykatës së caktuar me ligj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit nuk është i bazuar.

*D. Për pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve*

31. Lidhur me cenimin e parimit të barazisë së armëve kërkuesi parashtron se Gjykata e Apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij dhe se kjo shkelje nuk është korriguar as nga Gjykata e Lartë.

32. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve përbën një nga elementet më thelbësore të procesit të rregullt ligjor. Ky standard kushtetues nënkupton që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi, për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e venë në disavantazh me palën tjetër. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës tjetër dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuesit, nëpërmjet mbrojtësit të tij, në të gjitha shkallët e gjykimit i është dhënë mundësia për t'u njohur dhe për të debatuar mbi të gjitha provat, si dhe për të paraqitur argumentet dhe provat e tij në lidhje me çështjen. Ndërsa mënyra e vlerësimit të tyre, sipas jurisprudencës së Gjykatës, nuk hyn në juridiksionin kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, si dhe të vlerësimit të fakteve dhe rrethanave të tyre nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 13, datë 10.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se edhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

34. Si përfundim, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë



duhej të investohej për t'u dhënë përgjigje në themel pretendimeve të kërkuarit, duke realizuar në këtë mënyrë të drejtën e aksesit, si dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial nëpërmjet një vendimi të arsyetuar. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuarit në këtë drejtim janë të bazuara dhe duhen pranuar.

**PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f, dhe 134/1/g, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

**VENDOSI:**

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-1109, datë 16.4.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

**VENDIM**

*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 1624 (420), datë 11.4.2016, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Gramos Memushaj, i biri i Çumanit dhe i Lules, i datëlindjes 5.6.1977, në datën 12.2.1999, si dhe caktimin si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij, vëllanë e tij, shtetasin Adriatik Memushaj.

**VENDIM**

*(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 53, datë 25.1.2016, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Klodian Londo, i biri i Perikliut dhe i Sofikës, i datëlindjes 8.7.1973, me vendlindje në Berat, si dhe caktimin e shtetasës Sofika Qako, e bija e Vasilit dhe e Gjinovefës, si kujdestare të pasurisë së tij.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë